



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 245

Tiranë – E enjte, 18 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 22.11.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë” 13455
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 55, datë 29.12.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Shkodër..... 13455
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 56, datë 29.12.2017	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetës- Kanalizime Korçë sh.a..... 13456
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 57, datë 29.12.2017	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 13, datë 30.3.2017, “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat - Kuçovë” 13457
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4270/2, datë 27.12.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Kadri Qystri”, Lushnjë..... 13458
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetases Rita Murati... 13458

**VENDIM****Nr. 822, datë 22.11.2017****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, në kapitullin VI, pas nënpikës 6.4, të pikës 6, “Festat zyrtare, ditë përkujtimore dhe ditë të tjera, të shënuara”, shtohet nënpika 6.5, me këtë përmbajtje:

“6.5. Realizimi i dekorit të godinave të ministrive me rastin e festave zyrtare, të parashikuara në nënpikën 6.2., të këtij kapitulli, të bëhet nga Bashkia Tiranë, bazuar në kërkesat e ministrive. Marrëdhëniet ndërmjet ministrive dhe Bashkisë Tiranë për realizimin e dekorit të ministrive rregullohen me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.”.

2. Ngarkohen ministritë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 55, datë 29.12.2017****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër, me:

Drejtues ligjor: Mark Molla

Drejtues teknik: Lazer Pemaj

Drejtues teknik: Blerina Arrtunda

2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Shkodër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

Kategoria D: Për përpunimin e ujërave të ndotura (ITUN-ja e Shirokës dhe e Velipojës).

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Shkodër.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 56, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME
KORÇË SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e

dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, për zonën ekzistuese si më poshtë:

Kategoria e klientëve	Tarifa volumetrike		Tarifa fikse
	Furnizim me ujë (lekë/m ³)	Largimi i ujërave të ndotura (lekë/m ³)	(lekë/klient/muaj)
Klientë familjarë	72	42	140
Klientë publikë	117	64	140
Klientë privatë	140	64	140

b) Për shërbimin e furnizimit me ujë për zonat e reja:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Njësitë administrative			
			Mollaj, Bulgarec Qendër	Voskop, Komuna Vithkuq, Bulgarec (të tjerat)	Drenovë	Voskopojë
1	Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	38	28	28	28
2	Konsumatorë publikë	lekë/m ³	110	110	110	110
3	Konsumatorë privatë	lekë/m ³	100	100	100	100
4	Tarifë fikse	lekë/muaj/klient	100	100	100	100

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	93%
Mbulimi me kanalizime	73%
Niveli i matjes	91%
Uji pa të ardhura	25%
Norma e arkëtimit	94%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 23.12.2013, “Për miratimin e tarifave të

ujit për konsum publik për sh.a. UK Korçë”, shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 57, datë 29.12.2017**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË
VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 13, DATË 30.3.2017,
“MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË
UK BERAT - KUÇOVË”**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin

e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 13, datë 30.3.2017, “Për tarifën e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat - Kuçovë sh.a., bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 1, pas pikës “b” shtohen pikat “c”, “ç” dhe “d”, si më poshtë:
c) Tarifë volumetrike

Kategoria e shërbimit	Njësia	Njësitë administrative	
		Otllak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas	Roshnik
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë			
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	50	40
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³	150	150
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³	150	150
b) Për largimin e ujërave të ndotura			
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³	14	14
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³	24	24
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³	24	24

ç) Tarifa e shitjes së ujit me shumicë

Për UK Poliçan: 5.4 lekë/m³

d) Tarifa fikse

Kategoria e konsumatorëve	Njësia	Njësitë administrative	
		Otllak, Velabisht, Sinje, Kozare, Lumas, Roshnik	
1. Konsumatorë familjarë	lekë/m ³		100
2. Konsumatorë publikë	lekë/m ³		200
3. Konsumatorë privatë	lekë/m ³		200

b) Pika 2 e vendimit ndryshon si më poshtë:

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 janë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Mbulimi me ujë	78%
Mbulimi me kanalizime	62%
Niveli i matjes	67%
Uji pa të ardhura	65%
Norma e arkëtimit	86%

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

**KËRKESË**

Nr. 4270/2, datë 27.12.2017

**PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES
PUBLIK, TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIMI I BLOKUT TË BANIMIT
NË LAGJEN “KADRI QYSTRI”,
LUSHNJË**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen “Kadri Qystri”, Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 1,281,588 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**

VLERA E SHPRONËSIMIT TË TRUALLIT TË
Z. THOMA SEMINI NË LAGJEN “KADRI QYSTRI”,
ZONA KADASTRALE 8571

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	Nr. i pasurisë	Emër, mbiemër	Zona kadas.	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	11.183	Thoma Semini	8571	Truall	m ²	132	9709	1,281,588	Shkresa nr. 1922/1, datë 20.3.2017
SHUMA TOTALE								1,281,588	

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2003, datë 4.12.2017, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Rita Murati, e datëlindjes 13.4.1960, në datën 4.6.1991.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë